



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë 12.09.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 12.09.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Arioza Travel shpk nga Lipjani**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Transporti i nxënësve në relacionin nga Lagjeja Akllapit deri në SHFMU "Vëllezrit Frashëri" Lipjan dhe anasjelltas llot 11"**, me Nr. të Prok: 613-23-6624-2-1-1 nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik **Arioza Travel shpk nga Lipjani** e datës 12.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Transporti i nxënësve në relacionin nga Lagjeja Akllapit deri në SHFMU "Vëllezrit Frashëri" Lipjan dhe anasjelltas llot 11"**, me Nr. të Prok: 613-23-6624-2-1-1 kundër *Vendimit të AK –së*, të datës 05.09.2023 të publikuar në platformën elektronike e-prokurimi.

Mbetet në fuqi *Vendimi i AK për shpërblim me kontratë për: "Autotransporti" Sh.a., Dardhishtë - Obiliq*, të publikuar me datë: 05.09.2023.

2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik **Arioza Travel shpk** nga **Lipjani** më datë 11.09.2023 ka parashtruar ankesë lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Transporti i nxënësve në relacionin nga Lagjeja Akllapit deri në SHFMU "Vëllezrit Frashëri" Lipjan dhe anasjelltas llot 11"**, me Nr. të Prok: 613-23-6624-2-1-1 për shpërblim me kontratë, për: **"Autotransporti" Sh.a., Dardhishtë - Obiliq**, të publikuar me datë: 05.09.2023 te publikuar ne platformen elektronike e-prokurimi.

Autoriteti Kontraktues, me datë 12.09.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si ne vijim:

Sa i perket pretendimit tuaj, Autoriteti Kontraktues perkatesishte komisoni per vleresimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tendereve ka vepruar konforme dispozitave te nenit 59 te LPP-se, sepse gjate vleresimit ekzaminimit dhe krahasimit te tendereve ka konstatuar se Operatori Ekonomik i rekomanduar per kontrate e ka çmimin jo normalishte te ulet, mirpo Autoriteti kontraktues me ane te dergimit te Letres standarde e kerkeses per informata mbi tenderin jo-normalishte te ulet, ka kerkuar nga tenderuesi qe te siguroje nje sqarim me shkrim se s'i do t'i kryej keto sherbime me çmimin e ofruar. Operatori Ekonomik ne deklaraten e tij eshte pergjigjur se do te beje realizimin e ketij sherbimi sipas specifikave teknike te dosjes se tenderit me arsyetimin se kemi punetor te mjaftueshem dhe se na pershtatet orari, si dhe arsyeja kryesore eshte afersia shtepi-shkolle. Autoriteti Kontraktues pas marrjes parasysh te keteyre informacioneve dhe shpjegimeve qe jane dorezuar me shkrim nga tenderuesi ka konstatuar se tenderuesi ka dorezuar shpjegim te mjaftueshem te bazave te tenderit te tij.

Te bashkangjitur ne kete vendim e keni edhe letren standarde te derguar Operatorit Ekonomik nga ana e Autoritetit Kontraktues, si dhe pergjigjen e tij ne lidhje me kete çeshtje.


Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Bekim Shabani



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit



KOMUNA E LIPJANIT

Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët

jo-normalisht të ulët

23.08.2023

Komuna e Lipjanit rruga "Shqipëria" nr 28

"Autotransporti" Sh.a., Dardhishtë, -, KRUSHEFC-OBILIQ, Kosovë

Nr. i Prokurimit:	613	2	3	6	6	2	4	2	1	1
-------------------	-----	---	---	---	---	---	---	---	---	---

Titulli: Transporti i nxënësve në relacionin nga Lagjeja Akllapit deri në SHFMU "Vëllezrit Frashëri" Lipjan dhe anasjelltas llot 11

I/e nderuar(a) ☒ Blerim Januzi

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kriterëve të dhëna në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Ne konsiderojmë që tenderi juaj është jo-normalisht i ulët në krahasim me objektin e kontratës.

Që të mund ta vlerësojmë tenderin tuaj në mënyrën e duhur, kërkojmë nga ju të jepni një shpjegim detal të elementeve përbërëse të tenderit tuaj në vijim:

Komisioni vlerësues pas vlerësimit të ofertës tuaj konstaton se çmimi i ofruar nga ana e juaj është jo-normalisht i ulët dhe ne si komision kërkojmë sqarime detale se si do t'i kryeni këto shërbime me çmimin e ofruar.


Informatat e kërkuara duhet të pranohen me shkrim duke ngarkuar përgjigjen në platformën elektronike e-prokurimi deri me datën 24.08.2023 në ora 15:00.

Nëse nuk marrim përgjigje nga ju mbi pyetjet e lartë shënuara brenda afatit kohor të dhënë, tenderi juaj do të refuzohet.

Ju falënderoj paraprakisht,

Me respekt,

Bekim Shabani


Nënshkrimi

AUTOTRANSPORTI SH.A
DARDHISHTË P.N
TEL: 045 126 621
E-mail : blerim.januzi13@hotmail.com



Datë : 24.08.2023

Për:
Autoritetin Kontraktues : **KOMUNA E LIPJANIT**
Adresa: **Rr. "Shqipëria" nr28**

Lidhur me projektin:

Me Nr. Të Prokurimit 631 23 66 24211

Transporti i nxënsëve ne relacionin ng Lagjeja e Akllapit deri në SHFMU "Vëllezrit Frashëri" Lipjan dhe anasjelltas Lot11

DEKLARATË

Për realizimin e projektit sipas specifikimeve teknike

Ne operatori Ekonomik Autotransporti sh.a deklarojm se do të bëjmë realizimin e projektit sipas specifikimeve teknike, dhe arsyeja pse është çmimi I ulët ne kemi punëtor mjaftueshem dhe na përshtatet orari por edhe nje nga arsyet kryesore është afërsia Shtëpi -Shkoll.

Nëse ju hezitoni që të na shpërbleni me kontrat për mos përmbushje të kontrates se çmimi është tejet I ulët ju e keni edhe mundësin e kofiskimit të sigurimit së ekzekutimit të kontratës qe ne duhet me u'a sjell.

Me respekt!

Blerim Januzi